



**PËRBËN VEPËR
PENALE DHE
DËNOHET ME
BURGIM**

INFRASTRUKTURA ARSIMORE NË FUSHATË

RAPORT MONITORIMI

Mars 2025



PËRMBAJTJA:

1. HYRJE	3
2. METODOLOGJIA.....	4
2.1. Metodologjia e monitorimit.....	4
2.2. Metodologjia e studimit.....	4
3. KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR	5
3.1. Cilat janë disa nga ndalesat në një veprimtari publike?	6
3.2. Çfarë u lejohej dhe çfarë u ndalohej të bëjnë punonjësit e institucioneve arsimore në këtë fushatë zgjedhore?	7
3.3. Mekanizmat e Mbikëqyrjes dhe Sanksionet	8
4. ANALIZË MBI PËRDORIMIN E ASETVE PUBLIKE TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE	8
4.1. Përdorimi i rrjeteve zyrtare sociale të institucioneve arsimore në mbeshtetje të Fushatës Zgjedhore të Partisë Socialiste	9
4.2. Përdorimi i ambienteve publike të institucioneve arsimore	13
4.3. Takimi i Rektorit të Universitetit Bujqësor të Tiranës me grupin parlamentar të PS.....	17
4.4. Nisma “Kuvendojmë për Shqipërinë”, përdorim i fondeve publike për aktivitete politike	19
5. GJETJET KRYESORE:	21
6. REKOMANDIME.....	22
7. ANEKSE.....	23



1. HYRJE

Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri janë një moment kyç për demokracinë dhe zhvillimin e vendit. Për të garantuar një proces zgjedhor të drejtë dhe të paanshëm, është thelbësore që institucionet publike, përfshirë ato arsimore, të ruajnë neutralitetin dhe të mos keqpërdorin burimet e tyre për qëllime elektorale.

Më 5 Dhjetor 2024, Presidenti i Republikës, z. Bajram Begaj, me Dekret Nr. 399¹, caktoi datën 11 Maj 2025 si ditën për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë. Nga ana tjetër procesi parazgjedhor në Shqipëri filloi 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve, përkatësisht në datën 11 Janar, sipas përcaktimeve të KQZ-së (Komisionit Qendror të Zgjedhjeve). Në këtë periudhë, është vërejtur shpesh një tendencë e përdorimit të burimeve publike për qëllime elektorale, një praktikë kjo që cënon parimin e barazisë në garën zgjedhore dhe integritetin e procesit demokratik.

Raportet ndërkombëtare dhe vendase kanë evidentuar raste të keqpërdorimit të burimeve administrative gjatë proceseve zgjedhore në Shqipëri. Sipas një anketimi të zgjedhjeve të fundit, rreth 31% e qytetarëve kanë deklaruar se kanë qënë dëshmitarë të përdorimit të burimeve shtetërore për qëllime zgjedhore. Ky fenomen përfshin përdorimin e infrastrukturës dhe personelit të institucioneve arsimore për aktivitete politike, duke shkelur standardet e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

Në zgjedhjet e këtij viti, vëzhgimet paraprake tregojnë se kjo praktikë vazhdon të jetë e pranishme, pavarësisht reformave dhe rritjes së ndërgjegjësimit për nevojën e një administrate neutrale.

Në vitin 2025, është raportuar se disa shkolla dhe universitete janë përdorur për organizimin e aktiviteteve të subjekteve politike, kryesisht të partisë në pushtet, ndërkohë që një pjesë e administratës arsimore është angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në fushatë. Kjo vë në pikëpyetje efektivitetin e masave mbrojtëse dhe rolin e institucioneve përgjegjëse në mbikëqyrjen e neutralitetit të administratës publike.

Ky raport synon të analizojë në detaje fenomenin e vënies në dispozicion të burimeve publike nga institucionet arsimore gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025. Duke u bazuar në të dhëna konkrete, raporte të organizatave monitoruese dhe reagimet institucionale, raporti do të identifikojë modelet e keqpërdorimit, do të vlerësojë ndikimin e tyre në procesin zgjedhor dhe do të ofrojë rekomandime për përmirësimin e situatës në të ardhmen.

¹ <https://president.al/presidenti-begaj-dekreton-caktimin-e-dates-se-zgjedhjeve-per-kuvendin/>

2. METODOLOGJIA

Prej datës 11 Janar 2025, institucionet dhe zyrtarët publikë janë të detyruar të zbatojnë kufizimet e përcaktuara në Nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor. Këto masa synojnë të parandalojnë abuzimin me burimet shtetërore gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 11 Majit 2025.

Më 21 Dhjetor 2024, Komisioni Rregullator rishikoi Vendimin nr. 9, miratuar më 24 Dhjetor 2020, duke ofruar një përshkrim më të detajuar të aktiviteteve që nuk lejohen për promovim, kufizimeve për zyrtarët publikë dhe rregullave për raportimin e veprimtarive publike. Gjithashtu, u përcaktuan procedurat që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mund të ndjekë në rast të denoncimeve apo mospërbushjes së detyrimit për raportim nga institucionet shtetërore.

2.1. Metodologjia e monitorimit

- Mbledhja e të dhënave përmes vëzhgimeve, raportimeve mediatike dhe analizës së dokumenteve zyrtare, duke analizuar format e përdorimit të aseteve publike dhe vënien në dispozicion të tyre për partitë politike në kuadër të fushatës zgjedhore.
- Analiza e raportimeve pranë KQZ të denoncimeve kundrejt institucioneve arsimore në kuadër të vënieve në dispozicion të aseteve publike për kandidatët apo partitë politike.
- Vëzhgimi i institucioneve arsimore prej datës 11 Janar 2025, si edhe rrjeteve sociale zyrtare të tyre duke analizuar përputhshmërinë e aktivitetit me nenet përkatëse të Kodit Zgjedhor.

2.2. Metodologjia e studimit

Ky studim do të ndërthurë metoda cilësore dhe sasiore për të dhënë një panoramë sa më të saktë të përfshirjes së institucioneve arsimore publike të të gjitha niveleve në procesin parazgjedhor. Nga ana tjetër do të trajtojë raste të përdorimit të burimeve publike nga këto të fundit. Metoda cilësore do të përfshijë kuadrin rregullator dhe dokumentet zyrtare, denoncimet dhe mënyrën e trajtimit të secilit rast, ndërsa metoda sasiore do të ketë për qëllim analizën e rasteve të vëzhguara apo të raportuara dhe përputhshmërinë e tyre me kuadrin rregullator dhe Kodin Zgjedhor.



3. KUADRI LIGJOR DHE RREGULATOR

Në Nenin 91 të Kodit Zgjedhor² thuhet se: "Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

Në kuptim të këtij neni, 'burime' quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në Nenin 142 të Kodit Civil³, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të 'burimeve njerëzore' kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore.

Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimor, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Në këtë kontekst përfshihen edhe Institucionet Arsimore Publike të Republikës së Shqipërisë të të gjitha niveleve⁴:

1. Arsimi parashkollor (*nën varësinë e qeverisjes vendore*)
2. Arsimi fillor
3. Arsimi i mesëm i ulët (*8- ose 9-vjeçarja*)
4. Arsimi i mesëm i lartë (*gjimnazi*)
5. Arsimi universitar

Çfarë aktiviteteve publike ndalohen të bëhen 4 muaj para zgjedhjeve?

1. Shpërndarje legalizimesh, certifikata pronësie, akteve për regjistrimin e tokës bujqësore.
2. Promovimi i veprimtarive për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo

² Neni 91 i Kodit Zgjedhor "Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore", (<https://kqz.gov.al/pdf/kodi-zgjedhor.pdf>)

³ Neni 142 i Kodit Civil "Llojet e Sendeve", faqja 31,

(https://www.drejtesia.gov.al/wpcontent/uploads/2017/11/Kodi_Civill-2014_i_azhornuar-1.pdf)

⁴ <https://www.portalishkollor.al/news/perkufizimet-dhe-shkurtime-ne-sistemin-arsimor>

sipas planit buxhetor të miratuar. (Fushat: Transporti, Energjetika, Telekomunikacioni, Rinia, **Arsim**)

3. Dhënia e kontratave publike të koncensionit/partneriteteve publike private (PPP) për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen.
4. Përdorimi i detyruar në fushatë i nëpunësve ose punonjësve të administratës shtetërore qendrore ose vendore brenda orarit të punës për veprimtari ose aktivitete zgjedhore.

3.1. Cilat janë disa nga ndalesat në një veprimtari publike?

Shenjat, logot, pankartat, sloganet, posterat, thirrjet apo fjalimet me përmbajtje partiake.

Institucionet shtetërore, duhet të ndjekin gjithashtu disa rregulla që ndalojnë përdorimin e burimeve dhe aseteve publike, 4 muaj para datës së zgjedhjeve.


1. Ndalohet përdorimi i çdo burimi njerëzor nga institucionet, përdorimi i aseteve dhe sendeve në pronësi të shtetit.
2. Përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore.
3. Përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore, premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Raportimi i këtyre aktiviteteve pranë KQZ-së është detyrim i drejtuesit të administratës së institucionit, ku duhet të përfshijë edhe folësit apo pjesëmarrësit. Në rast se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve konstaton se veprimtaria publike përbën veprimtari të ndaluar ose keqpërdorim të burimeve shtetërore, urdhëron ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë publike dhe ndërmerr masa administrative ndaj këtyre rasteve.



3.2. Çfarë u lejohej dhe çfarë u ndalohej të bëjnë punonjësit e institucioneve arsimore në këtë fushatë zgjedhore?

Vendimi Nr. 122, datë 26.2.2025⁵ i Këshillit të Ministrave, e bën të qartë monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor. Synimi është nxitja e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve e partive politike në marrëdhëniet me administratën shtetërore dhe burimet e saj, për krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike në procesin elektoral, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe burimeve publike për qëllime partiake.



VENDIM Nr. 122, datë 26.2.2025

Referuar vendimit, punonjësit të administratës shtetërore, **përfshirë këtu edhe punonjësit e institucioneve arsimore**, gjatë periudhës së procesit zgjedhor, i krijohen kushtet e nevojshme dhe i garantohet moscënimi i të drejtave dhe lirive themelore, kushtetuese, për të shprehur fjalën e lirë dhe për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislacionit në fuqi, që rregullojnë dhe janë të vlefshme gjatë këtij procesi zgjedhor.

Punonjësi i arsimit, pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

Punonjësi ka të drejtë të angazhohet si komisioner zgjedhor, në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, pasi të ketë njoftuar paraprakisht me shkrim eprorin direkt dhe njësinë e personelit për këtë veprimtari dhe të ketë marrë lejen me shkrim nga eprori direkt. Angazhimi si komisioner nuk duhet të ndikojë në përmbushjen e detyrave funksionale si pjesë e shërbimit civil. Nga ana tjetër, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda

⁵ <https://abz.gov.al/share/xtG6yAUvTxqPXjp0wiSeOA>

mjediseve të institucioneve arsimore, i ndalohet çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari politike apo fushatë zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

3.3. Mekanizmat e Mbikëqyrjes dhe Sanksionet

Institucionet shtetërore që nuk respektojnë detyrimet, rrezikojnë gjobë nga 3,000 deri në 90,000 lekë, duke ngritur pikëpyetjen nëse është mjaftueshëm për të mbajtur dikë larg abuzimit.

Nga data 11 Janar, çdo zyrtar publik që do të përdorë postin për qëllime zgjedhore rrezikon të ndëshkohet deri edhe në humbjen e pozicionit të tij, pavarësisht se kjo e fundit nga praktika zgjedhore në Shqipëri nuk ka zbatim në përgjithësi, por vjen vetëm e shënuar në letër.

4. ANALIZË MBI PËRDORIMIN E ASETVE PUBLIKE TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Sot, një nga çështjet më të rëndësishme dhe të përsëritura të vërejtura nga vëzhguesit e zgjedhjeve është keqpërdorimi i burimeve publike gjatë proceseve zgjedhore. Kjo theksohet edhe nga vëzhguesit ndërkombëtar si Komisioni i Venecias, OSBE dhe ODIHR, të cilët shprehen se hapësira e mundësive për keqpërdorim të burimeve publike në proceset zgjedhore është e gjerë dhe shpesh në Shqipëri zhvillohet në një mjedis ku keqpërdorimi ka ndodhur gjatë gjeneratave të ndryshme të zgjedhjeve, duke u kthyer në një kulturë politike dhe duke evokuar perceptimin se një 'shpenzim i fillë i keq-drejtuar' është normal⁶.

Ka karakteristika specifike kur përfaqësuesit e zgjedhur (ndoshta edhe kandidatë) kryejnë detyra specifike në administratën zgjedhore dhe gjithashtu kanë funksione specifike administrative edhe në sistemin arsimor.

Për më tepër, abuzimi i burimeve publike, adreson si sjelljet nga **punonjësit e institucioneve të arsimit** në cilësinë e tyre zyrtare, veçanërisht se si ata keqpërdorin detyrat/ mjetet e tyre për të nxitur votën për kandidatë të caktuar elektorale ose për shkak të pozitës së tyre nën presion për të mbështetur/votuar një kandidat ose parti specifike, e veçanërisht partinë në pushtet, si dhe sjelljen nga **mbajtësit aktual të pozitave si të zgjedhur dhe kandidatë** (zakonisht gjatë fushatës zgjedhore).

⁶ Cf. Udhëzime të përbashkëta të Komisionit të Venecias/OSBE/ODIHR për parandalimin dhe reagimin ndaj keqpërdorimit të burimeve administrative gjatë proceseve zgjedhore (14 mars 2016), CDL-AD(2016)004, rikujtimi i raportit të mëhershëm të 2013 CDL-AD(2013)033.

4.1. Përdorimi i rrjeteve zyrtare sociale të institucioneve arsimore në mbështetje të Fushatës Zgjedhore të Partisë Socialiste

Keqpërdorimi i aseteve shtetërore vijon të jetë një sëmundje e vjetër, teksa në krye të abuzimit janë institucionet arsimore, duke nisur nga shkollat deri tek zyrat vendore të arsimit. Raste të shumta të keqpërdorimit të burimeve administrative janë vërejtur gjatë misioneve të vëzhgimit të zgjedhjeve. Shembujt e mëposhtëm burojnë nga raportet e vëzhgimit të zgjedhjeve nga Qendresa Qytetare. Një nga problemet e identifikuar gjatë fushatës zgjedhore, është paqartësia e kufijve midis **shtetit dhe partisë**. Këto kufinj janë zbehur nga përdorimi i burimeve njerëzore (punonjësit e institucioneve të arsimit) dhe përzjerja e fushatave dhe detyrave zyrtare, p.sh., nga: përfshirja e mësuesve dhe nxënësve në ngjarjet e fushatës, apo vënia në dispozicion e faqeve zyrtare të institucionit arsimor në kuadër të fushatës zgjedhore. Kjo e fundit gjithashtu konsiderohet burim publik, për sa kohë i përket një institucioni shtetëror, si edhe është një nga fenomenet më të përhapura gjatë fushatës zgjedhore, por edhe para dhe pas saj.

Për sa me sipër, institucionet e arsimit parauniversitar kanë vënë në dispozicion që prej javës së parë të fazës parazgjedhore rrjetet e tyre sociale, në favor të fushatës së Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Sipas vendimit nr. 421, datë 03.05.2023⁷ nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, rrjetet sociale të institucioneve të administratës shtetërore do të konsiderohen si "burime publike", mbi të cilat do të rëndojnë të gjitha rregullimet ligjore që lidhen me asete të luajtshme ose të paluajtshme në administrim shtetëror, referuar nga Neni 91 pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Më 13 Janar, organizata "[Qëndresa Qytetare](#)" depozitoi një kallëzim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për 36 institucione arsimore të niveleve të ndryshme, me argumentin se këto të fundit, kanë përdorur faqet e tyre zyrtare për qëllime elektorale. Nga data 1 Janar dhe në vijim, monitoruesit e "Qëndresa Qytetare" kanë konstatuar se faqet zyrtare të institucioneve të arsimit parauniversitare, Zyrrave Vendore të Arsimit, si dhe faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, të gjitha këto institucione në varësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, janë angazhuar në forma të ndryshme, duke përfshirë pëlqimin, komentimin apo shpërndarjen, me postime që kanë në përmbajtje të tyre thirrje elektorale.

Janë 15 shkolla 9-vjeçare, 2 Shkolla të Mesme të Përgjithshme, një Shkollë e Mesme Pedagogjike, 13 Zyra Vendore Arsimore, 4 Drejtori Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, që në faqet e tyre zyrtare në rrjetet sociale kanë shpërndarë aktivitete

⁷ Vendim nr. 421, datë 03.05.2023, "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 222 ID, të organizatës "Komiteti Shqiptar i Helsinkit" dhe denoncimit nr. 228 të deputetit zj. Albana Vokshi ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, si dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023

elektorale të Ministres së Arsimit znj. Ogerta Manastirliut dhe Partisë Socialiste.

Sipas denoncimit, një pjesë e shkollave kanë shpërndarë në Facebook takimin e Ministres së Arsimit dhe Sportit, znj. Ogerta Manastirliu, në kuadër të fushatës zgjedhore⁸.

Postimi i ministres Manastirliu, publikuar më 11 Janar të këtij viti lidhej me një takim të zhvilluar në Greqi, në kuadër të zgjedhjeve, që priten të mbahen më 11 Maj.

“Athinë – Bashkë me Belinda Ballukun takuam Sarën, studenten ekselente të shkencave politike në Athinë, që ka dëshirën e pamatë për të kontribuar për Shqipërinë, duke nisur nga vota për herë të parë e për të bashkëpunuar edhe më tej për vizionin e #Shqipërisë2030”, shkruante Manastirliu në Facebook.

Shkolla 9-vjeçare "Neim Muçelli" Pretushë. Faqja zyrtare. 3h ·

Ogerta Manastirliu is with Belinda Balluku and 2 others in Athens, Greece. 7h ·

Takime entuziaste në Athinë me komunitetin shqiptar, që po tregojnë një interes të madh për ushtrimin e të drejtës së votës së diasporës në zgjedhjet e #11Majit, me dëshirën dhe krenarinë për ta çuar Shqipërinë në majën që i takon, në familjen e madhe evropiane.

*Regjistruhu në Platformën Elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: <https://diaspora.kqz.gov.al>

#DiasporaVotoni #KrenarëpërShqipërinë #VetëmPërpara #SHQIPËRIA2030



PrintScreen i Shpërndajës së Postimit Elektoral të Ministres së Arsimit, nga Shkolla “Neim Muçelli” Petrushë

Shkolla 9-vjeçare "Ismail Jangulli" Godvi

Posts About Photos More

Shkolla 9-vjeçare "Ismail Jangulli" Godvi 1d ·

Ogerta Manastirliu 2d ·

Me Delinën, Edisonin, Letën, Anilën dhe strukturat e #PSTiranë #Njësia5, vijojmë punën organizative në terren dhe për votën e diasporës, të angazhuar për fitoren e zgjedhjeve të #11Majit, si garancia për ta çuar Shqipërinë në majën që i takon, në familjen e madhe evropiane.

#PSTiranë #PS2030 për #Shqipërinë2030



PrintScreen i Shpërndajës së Postimit Elektoral të Ministres së Arsimit, nga Shkolla “Ismail Jangulli” Godvi

Në vijimësinë e vëzhgimit rezultoi se shkollat kanë fshirë postimin elektoral, madje disa prej tyre edhe postime të tjera që lidhen me Manastirliun gjatë muajit Janar, konkretisht: “Neim Muçelli” Pretushë, “Ismail Jangulli” Godvi, “Koli Dimo” Frashër, “Koli Sako”, shkolla Kajan (Jashar Dunga), shkolla 9-vjeçare “Alush Grepcka”, dhe ajo 9-vjeçare “Ahmet Zogu”.

Ndërkohë, disa institucione të tjera arsimore vijojnë të shpërndajnë postime të ministres Manastirliu, përveç atyre me karakter politik.

⁸ <https://www.facebook.com/share/p/1Muv71op7f/>

4.1.1 Si u argumentua shpërndarja e postimeve elektorale?

Më 27 Janar, në mbledhjen e zhvilluar për këtë çështje nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, përfaqësues të shkollave deklaruan se postimet janë fshirë me argumentin se shpërndarja e tyre ishte bërë në mënyrë aksidentale, pa pasur ndonjë qëllim politik.

“Është një postim i bërë nga një administratore e shkollës sonë. Nuk ka asnjë prapavijë politike, por thjesht një lapsus, një gabim, e cila nuk ka qenë korrekte në zbatimin ligjor që e predispozon ligji. Administratori kryesor i faqes nuk është pjesë e sistemit arsimor, por është një person i jashtëm”, tha drejtuesi i shkollës 9-vjeçare “Ismail Jangulli” Godvi.

Drejtoresha e shkollës 9-vjeçare “Mustafa Greblleshi” në Tiranë deklaroi se ka ngatërruar adresën personale në rrjetet sociale me atë të institucionit arsimor.

“Menjëherë sapo jam njoftuar me email nga Zyra Vendore Arsimore, unë jam futur në llogarinë e shkollës dhe vërtetë pashë që kisha bërë një ‘like’. Kjo është bërë pa vetëdije, sepse në telefonin tim celular, mund të vërtetohet kollaj, mbaj dy llogari, një personale dhe një të shkollës. Ngatërresa është pa tendencë dhe nuk jam as e shtyrë e as ndikuar nga dikush që unë të bëj postime të kësaj natyre”, u shpreh ajo.

Përdorimi i faqeve zyrtare të shkollave për qëllime politike, qoftë edhe nga pakujdesia, cënon parimet e paanshmërisë dhe besueshmërisë së institucioneve arsimore. Administrimi i kujdesshëm i komunikimit publik është detyrim ligjor dhe etik i çdo drejtuesi shkollor. Arsimi duhet të mbetet i lirë nga çdo ndikim politik, duke ruajtur integritetin dhe pavarësinë e tij.

Vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:



Më 27 Janar, në mbledhjen e zhvilluar për këtë çështje nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Në foto, pas, 40 drejtuesit e institucioneve Arsimore të denoncuar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi pushimin e çështjes, sepse arsyetoi që Kodi Zgjedhor ka qëllim ndërgjegjësores, jo ndëshkues dhe për aq kohë sa postimet ishin fshirë, nuk konstaton shkelje.



Por pas këtij denoncimi, në datën 4 Mars 2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me indicie nga zgjerimi i fenomenit, miratoi rregullat e përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online të institucioneve publike në zgjedhjet e 11 Majit:

Bazuar në Vendimin nr. 240, dt. 04/03/2025⁹, funksionarët publikë të çdo niveli nuk mund të përdorin direkt apo indirekt llogaritë e tyre zyrtare në rrjete sociale për qëllime partiake apo elektorale. Pasqyrimi i veprimtarive partiake dhe elektorale duhet të lejohet vetëm në llogaritë personale në këto rrjete.

Për sa më sipër më konkretisht:

1. Llogari zyrtare në rrjetet sociale është llogaria që është hapur dhe përdoret nga funksionari publik për shkak të detyrës që kryen, e cila përmban emrin e institucionit dhe funksionin publik, si dhe llogaria që është hapur dhe përdoret nga institucioni publik përkatës, përdorimi dhe përditësimi i së cilës bëhet nga strukturat përkatëse për median dhe informimin në këtë institucion. Nuk përfshihen në këtë përkufizim llogaritë personale dhe adresat në rrjetet sociale, të cilat përmbajnë vetëm emrin dhe mbiemrin e funksionarit publik dhe nuk lidhen me funksionin publik të tij.
2. Funksionarët publikë të çdo niveli nuk mund të përdorin direkt ose indirekt llogaritë e tyre zyrtare në rrjetet sociale për qëllime partiake apo elektorale. Pasqyrimi i veprimtarive partiake dhe elektorale lejohet vetëm në llogaritë personale në këto rrjete.
3. Ndalohet pasqyrimi i veprimtarive të ndaluara në rrjetet sociale të institucionit publik, si dhe në ato zyrtare të funksionarit publik.
4. Ndalohet pasqyrimi i veprimtarive politike dhe elektorale, si dhe postimi i mesazheve elektorale në faqet zyrtare të internetit, në rrjetet sociale të institucionit publik dhe në ato zyrtare të vetë funksionarit publik.

Edhe pse ka pasur një angazhim të përgjithshëm nga ana e drejtuesve të institucioneve arsimore publike për të shpërndarë dhe pëlqyer postimet e kandidatëve, si dhe për të përdorur platformat e rrjeteve sociale të institucioneve shtetërore për promovimin e aktiviteteve elektorale të kandidatëve për deputetë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka zbatuar një interpretim më të butë të rregullave të vendosura në Vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Kjo qasje ka treguar një "tolerancë", ndonjëherë pa argumente të mjaftueshme, për gabimet që ndodhin për shkak të menaxhimit të profileve të rrjeteve sociale nga personat përgjegjës. Gjithashtu, denoncimet e Qëndresa Qytetare kanë nxjerrë në pah shkeljen e

⁹ <https://www.facebook.com/share/1Grb8QL8QE/?mibextid=wwXlfr>

drejtpërdrejtë të parimeve të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe të rregullave të Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, duke krijuar një avantazh të padrejtë për disa kandidatë në garën zgjedhore.

4.2. Përdorimi i ambienteve publike të institucioneve arsimore

Institucionet arsimore, në parim, duhet të mbeten hapësira neutrale, të përkushtuara ndaj edukimit dhe të mbrojtura nga çdo lloj ndikimi politik. Megjithatë, në shumë raste, këto hapësira janë keqpërdorur për qëllime zgjedhore, duke u shndërruar në vende ku organizohen takime elektorale, shpërndahen materiale propagandistike apo edhe ushtrohet presion mbi stafin dhe nxënësit. Ky fenomen është shqetësues, pasi jo vetëm që çënon integritetin institucional, por edhe ndikon në procesin edukativ dhe në perceptimin e brezave të rinj mbi rolin e institucioneve publike në një shoqëri demokratike.

Për sa më sipër, në kuadër të fushatës zgjedhore, në mbështetje të Partisë Socialiste të Shqipërisë, më datë 15.03.2024, zhvillohet takimi elektorale për prezantimin e kandidatit për deputet, z.Olsi Komici.



Foto nga lidhja live nëpërmjet platformës Facebook të takimit elektorale në Librazhd. Në foto, në të djathtë z.Mariglen Disha, Kryetar i Bashkisë Librazhd, i dyti në të djathtë z.Taulant Balla, Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, i pari majtas z.Olsi Komici, Kandidat për deputet i PS-së, e dyta majtas znj.Bora Muzhaqi, Ministre e Rinisë, , dhe në qendër z.Arbjan Mazniku, Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor.

Nga verifikimet e kryera rezultoi se takimi është zhvilluar në ambientet e palestrës së gjimnazit "Ibrahim Muça" në Librazhd, me qëllim promovimin e emrave të kandidatëve për deputetë të Partisë Socialiste.






Foto e Palestrës së Gjimnazit "Ibrahim Muça", që vërteton vendin e kryerjes së takimit elektoral.

Në këtë takim, sikurse rezulton nga postimet e kryera në rrjetin social Facebook¹⁰, kanë marrë pjesë z.Arbjan Mazniku, Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor, njëherazi drejtues politik i qarkut Elbasan, znj.Bora Muzhaqi, Ministre e Rinisë, z.Taulant Balla, Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentit, z.Olsi Komici, Kandidat për Deputet i Partisë Socialiste, i cili para kandidimit mbante postin e drejtorit të AKU-së dhe z.Mariglen Disha, Kryetar i Bashkisë Librazhd.

Gjatë këtij takimi të zhvilluar në palestrën e gjimnazit z.Arbjan Mazniku shprehet:

"Librazhdi ka qenë Bashkia me rezultatin më të mirë për partinë socialiste në zgjedhjet e fundit, më të mirin në republik dhe kjo nuk është e rastësishme."

Ndër të tjera ai vijon:

"Pyetja është se kush e ka mundësinë, kush e ka takatin, ta cojë Shqipërinë në Europë? Dhe përgjigjja për këtë është e thjeshtë, dhe Librazhdi e di më mirë se të gjithë këtë, e ka Edi Rama dhe Partia Socialiste dhe përveç fuqisë së Edi Ramës dhe Partisë Socialiste duhet një skuadër e mirë, me njerëz dhe gjithashtu me njerëz që i kanë të gjitha këto kapacitete për ta përfaqësuar siç duhet Shqipërinë dhe për të zgjidhur

¹⁰ Postimi i Arbjan Mazniku, <https://www.facebook.com/share/v/1Bjhvxzah/?mibextid=wwXlfr>
Postimi i Taulant Balla, <https://www.facebook.com/share/v/1XcxaYBsUL/?mibextid=wwXlfr>
Postimi i Bora Muzhaqi, <https://www.facebook.com/share/v/1BjdvfjzS/?mibextid=wwXlfr>
Postimi i Mariglen Disha, <https://www.facebook.com/share/v/1H6RkD9Gok/?mibextid=wwXlfr>

hallet e territorit, të zonës ku jemi ne dhe sigurisht kryetari¹¹ ka bërë një punë të jashtëzakonshme në qytet dhe zhvillimin e zonës, territorit...”

Deklaratat e z. Arbjan Mazniku gjatë takimit në palestrën e gjimnazit në Librazhd përmbajnë një mesazh të qartë elektoral, ku theksohet mbështetja e lartë për Partinë Socialiste në këtë bashki dhe prezantimi i saj si e vetmja forcë politike që mund ta çojë Shqipërinë në Europë. Ai lidh drejtpërdrejt suksesin e zhvillimit të zonës me punën e kryetarit të bashkisë dhe qeverisjes së PS-së, duke krijuar një narrativë propagandistike për të ndikuar tek votuesit.

Analiza Ligjore:

Nga interpretimi sistematik i dispozitave të Kodit Zgjedhor me ato të Vendimit nr. 9, të Komisionit Rregullator, që të ndodhemi përballë një shkeljeje administrative që lidhet me (keq)përdorimin e burimeve shtetërore, duhet që të plotësohen disa kushte në mënyrë kumulative.

Së pari, duhet që veprimtaria të jetë kryer nga një prej subjekteve të ngarkuar me detyrime nga ligji dhe aktet nënligjore. Së dyti, duhet që veprimtaria të përfshijë vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në Nenin 142, të Kodit Civil, që janë në pronësi apo administrim të organeve publike. Së treti, duhet që vënia në dispozicion e aseteve publike të jetë bërë për qëllime zgjedhore.

1. *Përsa i takon kushtit të lidhur me subjektet*, ligjvënësi në pikën 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor bën një përcaktim të përgjithshëm duke sanksionuar se me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj, burimet publike nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të partive, apo të kandidatëve, të partive ose të koalicioneve në zgjedhje. Në rastin konkret, burimi publik i vendosur në dispozicion të Partisë Socialiste është palestra e Gjimnazit publik "Ibrahim Muça", e përdorur për takimin elektoral që përmban elementë të qartë të fushatës zgjedhore, referuar dhe ligjit. Për rrjedhojë, ky kusht i pari në lidhje me subjektin në këtë çështje cilësohet i plotësuar.
2. *Përsa i takon kushtit të dytë të lidhur me vënien në dispozicion të burimeve publike*, duhet që burimet të jenë asete të luajtshme ose të paluajtshme në pronësi të organeve publike qendrore ose të njësive të vetëqeverisjes vendore. Siç rezulton edhe nga rrethanat e çështjes, në rastin konkret, ambjenti i Gjimnazit "Ibrahim Muça" është përdorur për llogari të forcës politike, Partia Socialiste me qëllim që kjo e fundit të mund të përfitojë një avantazh të padrejtë. Përsa më sipër, në rastin konkret, provohet tërësisht përmbushja e këtij kushti të dytë.

¹¹ Këtu i drejtohet Kryetarit të Bashkisë Librazhd z. z. Mariglen Disha

3. *Përsa i takon kushtit të tretë që lidhet me qëllimin e vënies në dispozicion të aseteve publike, referuar pikës 2, të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, për efekt të ngarkimit me përgjegjësi administrative duhet që vënia në dispozicion e aseteve shtetërore e publike të jetë bërë për qëllime zgjedhore.*

Ky aktivitet, dukshëm përbën një shkelje të Nenit 91 të Kodit Zgjedhor, i cili ndalon zhvillimin e aktiviteteve zgjedhore në institucionet arsimore publike.

Organizimi i një takimi politik në ambientet e një gjimnazi publik bie ndesh me këtë dispozitë, pasi institucionet arsimore duhet të mbeten të ndara nga fushata dhe ndikimet politike. Kjo shkelje rëndohet edhe më shumë nëse burimet publike janë përdorur për realizimin e aktivitetit, pasi Kodi Zgjedhor ndalon qartësisht përdorimin e institucioneve dhe aseteve shtetërore për avantazhin e një partie politike.

Në këtë kontekst, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të ndërmarrë masa administrative kundër organizatorëve të këtij aktiviteti dhe subjektit zgjedhor të përfshirë, ndërsa përsëritja e rasteve të tilla duhet të trajtohen me seriozitet.

Bazuar në kuadrin ligjor, përdorimi i ambienteve publike të institucioneve arsimore për aktivitete elektorale shkel dispozitat e **Ligjit nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"**, si dhe **Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor"**.

Në mënyrë të veçantë, ky veprim bie në kundërshtim me:

- **Nenin 8 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar**¹², që përcakton se institucionet arsimore publike janë **hapësira neutrale**, të pavarura nga ndikimet politike.
- **Nenin 5, pika 2, germa a), të Ligjit për Arsimin e Lartë**¹³, i cili garanton **autonominë institucionale** dhe ndalon ndërhyrjet politike në administrimin e universiteteve dhe institucioneve të arsimit të lartë.
- **Nenin 91 të Kodit Zgjedhor**¹⁴, i cili ndalon përdorimin e burimeve dhe infrastrukturës shtetërore për qëllime elektorale nga partitë politike.

Nga të dhënat dhe analiza e bërë, është e qartë se fenomeni i përdorimit të institucioneve arsimore për fushata zgjedhore përbën një problem serioz që kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Është e domosdoshme që

¹² Neni 8, faqe 21, <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/Permbledhje-parauniversitari-8-Tetor-2020.pdf>

¹³ Neni 5, pika 2, germa a, faqe 19, <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2019/08/P%C3%ABrmbledhje-e-legjislacionit-p%C3%ABr-arsimin-e-lart%C3%AB-23-shtator-2020.pdf>

¹⁴ Neni 91, faqe 52, <https://kqz.gov.al/pdf/kodi-zgjedhor.pdf>

institucionet shtetërore të forcojnë mekanizmat ligjorë dhe të sigurojnë zbatimin rigoroz të rregullave për ndalimin e këtyre praktikave. Një qasje më e ashpër ndaj shkelësve të ligjit dhe vendosja e sanksioneve më të rrepta do të ndihmonte në uljen e rasteve të abuzimit.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është rritja e ndërgjegjësimit publik mbi këtë çështje. Organizatat e shoqërisë civile dhe media duhet të luajnë një rol kyç në ekspozimin e rasteve të shkeljeve dhe në informimin e qytetarëve mbi rëndësinë e mbrojtjes së institucioneve arsimore nga ndikimet politike.

Si përfundim, është e nevojshme që vetë institucionet arsimore të forcojnë autonominë e tyre dhe të refuzojnë çdo ndërhyrje politike në hapësirat e tyre. Drejtuesit e shkollave duhet të jenë të mbrojtur nga presionet politike dhe të inkurajohen të raportojnë çdo tentativë për keqpërdorim të infrastrukturës arsimore për qëllime elektorale. Vetëm përmes një angazhimi të përbashkët të institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe qytetarëve mund të arrihet një sistem arsimor i lirë nga ndërhyrjet politike dhe të garantohet një proces edukativ cilësor dhe i pavarur.

4.3. Takimi i Rektorit të Universitetit Bujqësor të Tiranës me grupin parlamentar të PS

Gjykata e Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (GJKKO) vendosi në datën 25 Shkurt 2025, 24 masa sigurie për punonjës të Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), pas kërkesës së SPAK, e cila po i heton për korrupsion dhe abuzime me tenderë.

Sipas SPAK¹⁵, hetimet kanë zbuluar përfshirjen e zyrtarëve të UBT-së në veprime korruptive të shtrira në kohë, ku ndër të tjera janë hetuar nëntë procedura prokurimi të zhvilluara në vitin 2022 me vlerë prej 90 milionë lekësh, veçanërisht në procesin e përgatitjes dhe zhvillimit të procedurave të prokurimeve publike.

“Hetimi, i nisur tre vite më parë, ka çuar në arrestimin e 5 personave, vendosjen e 10 të tjerëve në arrest shtëpie dhe detyrimin për paraqitje për 9 të tjerëve. Mes tyre janë dy zëvendësrektorë, pedagogë, drejtorë prokurimesh dhe specialistë të IT-së.”- shkruhet në artikullin e Citizen Channel¹⁶.

Sipas SPAK grupi i marrë nën hetim frynte fondet limite të prokurimeve pa bërë studime tregu dhe për rrjedhojë kanë ofruar tenderë me vlera të larta.

¹⁵ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-25-02-2025/>

¹⁶ <https://citizens.al/2025/02/26/rektori-i-ubt-se-rrefehet-para-ps-se-ndersa-spak-heton-abuzimet-me-tenderet/>

Per sa me sipër, Rektori i UBT-së, Fatbardh Sallaku, në datën 26 shkurt 2025, datë e cila përkon me fazën parazgjedhore, një ditë pas njoftimit të SPAK, foli para grupit parlamentar të mazhorancës rreth çështjes së abuzimeve me tenderët.



Momente gjate takimit të rektorit të UBT-së me grupin parlamentar të Partisë Socialiste

Prezenca e tij ishte lajmëruar të martën¹⁷, datë 25 Shkurt 2025, nga vetë Kryeministri Edi Rama, i cili i konsideroi masat e GJKKO “pa gjyq” duke relativizuar me vlerën e tenderëve, që sipas tij “ishin më pak se 30 milionë lekë”.

*“Kur e pyeta rektorin për çfarë shume bëhet fjalë, më tha është nën 300 milion të vjetra, pastaj pashë që është dhe më shumë. Rektori thotë që nuk e di se ku kanë dalë më shumë, por kaq janë projektet për të cilat dy vjet ka ai që e ka lënë telefonin në SPAK.”*¹⁸- shprehet kryeministri, z. Rama.

Gjatë fjalës së tij, Sallaku u fokusua te arritjet e universitetit dhe nisja e një reforme të thellë akademike sipas modelit të Universitetit Bochus në Vjenë. Ai u shpreh se ishte informuar nga media për masat e sigurisë dhe se stafi i universitetit kishte vendosur të mos komentonte vendimet e drejtësisë, si edhe **se ishte falënderues grupit parlamentar të PS** për mundësinë e takimit.

Rektori i një universiteti publik është i zgjedhur nga stafi akademik dhe studentët, ndaj vetëm atyre u ka përgjegjësi dhe vetëm para tyre duhet të japë llogari. Ai nuk duhet të jetë i varur nga asnjë grup parlamentar apo organ tjetër politik, pasi një lidhje e tillë cënon drejtpërdrejt autonominë e universitetit. Prania e një rektori të një universiteti publik, i cili duhet të jetë i pavarur, në një mbledhje të një grupimi politik parlamentar, tregon qartë se arsimi i lartë po përdoret për interesa dhe axhenda të caktuara politike, duke e vënë institucionin akademik në

¹⁷ <https://x.com/ediramaal/status/1894322895335354619>

¹⁸ <https://www.facebook.com/share/r/16HZG7RA2w/?mibextid=wwXlfr>, nga minutazhi 37:10 deri 37:27.

shërbim të interesave të një partie apo grupimi politik. Aq më shumë këtë ta vendosim në kontekstin ku ishin ndërmarrë 24 masa sigurie për punonjës të këtij universiteti.

4.4. Nisma “Kuvendojmë për Shqipërinë”, përdorim i fondeve publike për aktivitete politike

Në Tetor 2024, Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Elisa Spiropali, nisi një iniciativë të quajtur “Kuvendojmë për Shqipërinë”, që kishte si qëllim informimin e qytetarëve mbi projektligje dhe nisma të rëndësishme për ta, si dhe mbledhjen e mendimeve dhe propozimeve të tyre. Sipas Kuvendit, kjo iniciativë është pjesë e Planit Strategjik të Kuvendit për periudhën 2020–2025 dhe përfshin takime me zyrtarë lokalë, qytetarë dhe grupe interesi, si dhe sesione për të rinjtë.

Gjatë këtij turi, Kryetarja e Kuvendit, bashkë me Kryetarët e Bashkive të Dimalit, Peqinit dhe Himarës, vizituan shkolla te arsimit parauniversitar. Sipas monitorimit të Qendresa Qytetare, këta të fundit, kanë vizituar më konkretisht, **shkollën 9 – vjeçare “Meleq Gjozi” në Gorican, Dimal, gjimnazin “Zihni Magani” në Peqin, dhe gjimnazin “Spiro Gjikhuri” në Himarë.**

Në vijim do të ilustrojmë me foto vetëm rastin me **gjimnazin “Spiro Gjikhuri” në Himarë, 11 Shkurt 2025, për ta përmbledhur fenomenin edhe me rastet e tjera.**



Foto e takimit në gjimnazin “Spiro Gjikhuri” në Himarë¹⁹

Gjatë këtyre vizitave është ndërprerë mësimi dhe është detyruar pjesëmarrja, për t’i dhënë mundësi atyre të dëgjojnë fjalimin e Kryetares së Kuvendit znj. Spiropali, ku raportohet se kjo e fundit ka përdorur mesazhe politike.

¹⁹Bledi Çuçi - [#KuvendojmëPërShqipërinë](#) Një takim i bukur në gjimnazin “Spiro Gjikhuri” në Himarë, ku bashkë me kryetaren e Kuvendit, Elisa Spiropali, ftuam nxënësit për t’u bërë pjesë e programeve për të rinjtë me qëllim njohjen e veprimtarive parlamentare [<https://www.facebook.com/share/p/1Dt5MNRWfa/>]



Open Himara

3d •

...

Morra vesh që në Himarë nesër, te **gjimnazi Spiro Gjikhuri** do vej kryetarja e kuvendit, Spiropali...të gjithë janë tmerruar nga presioni i ushtruar...nxënësit janë urdhëruar të marrin pjesë në miting
Unë u bëj thirrje ta bojkotojnë, mos të ven e mos të kenë frikë..nuk ka arsye përse të vej në një shkollë..larg fëmijët nga politika e tyre
Pafytyrësia e tyre nuk ka fund..për çfarë arsye kryetarja e kuvendit të vej në një shkollë?

Print Screen i postimit të Open Himara, ku duket qartë natyra detyruese dhe politike e takimit

Megjithatë, këto aktivitete janë paraqitur si pjesë e detyrave normale të Kryetares së Kuvendit, kur në fakt ato janë të natyrës elektorale.

Më datë 11.03.2025, është zhvilluar turi i tretë i takimeve, duke filluar nga Himara dhe vijuar më pas në Vlorë. Gjatë këtij turi, krahas takimeve me kryetarët e bashkive, janë zhvilluar vizita në gjimnazin “Spiro Gjikhuri”; duke vijuar me takime me studentë të Universitetit “Ismail Qemali”, një darkë me gra biznesmene, si dhe takimi “Kuvend-On”.

Gjatë këtyre takimeve, vërehet qartazi edhe prezenca e z. Bledi Çuçi, të cilën, Kryetarja e Kuvendit e ka lidhur me pozicionin e tij si zëvendëskryetar i Kuvendit të Shqipërisë (është e natyrshme të përmendet këtu se në këto takime vërehet mungesa e zëvendëskryetarit të Kuvendit të Shqipërisë z. Gjekmarkaj, i cili përfaqëson krahun tjetër politik, Partinë Demokratike të Shqipërisë). Nga ana tjetër, z. Çuçi krahas funksionit të cituar më sipër, mban edhe funksionin e Drejtuesit Politik të Partisë Socialiste në Vlorë. Pikërisht ky fakt, si dhe video e transmetimit të takimit “Kuvend-On”, hedhin më tej dyshimet lidhur me natyrën tërësisht politike të këtyre aktiviteteve.

Sikundër rezulton, gjatë takimit, znj. Spiropali dhe z. Çuçi kanë bërë propagandë politike duke përdorur, ndër të tjera, shprehje si “votuesit tanë”, “Për inat të Edi Ramës dhe qeverisë, nuk mund t’i biesh Shqipërisë”; “reformën në drejtësi e kemi bërë me kosto të madhe politike”; “ne e kemi një lloj pengu si qeveri këto vite që qeverisim Shqipërinë”, etj.

Në rastin konkret, burimet publike të vendosura në dispozicion të Partisë Socialiste janë fondet e Kuvendit të Shqipërisë, si dhe institucionet arsimore, ku janë zhvilluar takimet e sipërcituara.

Sipas Kodit Zgjedhor, burimet publike nuk mund të përdoren për të mbështetur kandidatët apo partitë politike në periudhën zgjedhore, përveç rasteve të parashikuara nga ligji. Në këtë rast, përdorimi i burimeve publike nga Kuvendi i Shqipërisë dhe institucionet arsimore për aktivitete elektorale është një shkelje e këtij parimi.



5. GJETJET KRYESORE:

1. 36 institucione arsimore të niveleve të ndryshme, vunë në dispozicion faqet zyrtare të tyre në favor të fushatës elektorale të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Të gjitha këto institucione në varësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, janë angazhuar në forma të ndryshme, duke përfshirë pëlqimin, komentimin apo shpërndarjen, me postime që kanë në përmbajtje të tyre thirrje elektorale.
2. 15 shkolla 9-vjeçare, 2 Shkolla të Mesme të Përgjithshme, një Shkollë e Mesme Pedagogjike, 13 Zyra Vendore Arsimore, 4 Drejtori Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitare, në faqet e tyre zyrtare në rrjetet sociale kanë shpërndarë aktivitete elektorale të Ogerta Manastirliut dhe Partisë Socialiste.
3. Shkollat, [“Neim Muçelli” Pretushë](#), [“Ismail Jangulli”](#) Godvi, [“Koli Dimo”](#) Frashër, [“Koli Sako”](#), [shkolla Kajan](#) (Jashar Dunga), shkolla 9-vjeçare [“Alush Grepcka”](#), dhe ajo 9-vjeçare [“Ahmet Zogu”](#) kanë fshirë postimet elektorale, madje disa prej tyre edhe postime të tjera që lidhen me Manastirliun gjatë muajit Janar, duke u munduar të “fshihin” faktet e denoncimit.
4. Në kuadër të fushatës zgjedhore, në mbështetje të Partisë Socialiste të Shqipërisë, më datë 15.03.2024, zhvillohet takimi elektoral për prezantimin e kandidatit për deputet, z.Olsi Komici, në palestrën e Gjimnazit “Ibrahim Muca”, duke shkelur nenin 91 të Kodit Zgjedhor mbi përdorimin e burimeve publike.
5. Rektori i UBT-së, z. Fatbardh Sallaku, në datën 26 Shkurt 2025, datë e cila përkon me fazën parazgjedhore, një ditë pas njoftimit të SPAK, foli para grupit parlamentar [të mazhorancës](#) rreth çështjes së abuzimeve me tenderët. Rektori i një universiteti publik është i zgjedhur nga stafi akademik dhe studentët, ndaj vetëm atyre u ka përgjegjësi dhe vetëm para tyre duhet të japë llogari. Ai nuk duhet të jetë i varur nga asnjë grup parlamentar apo organ tjetër politik, pasi një lidhje e tillë cënon drejtpërdrejt autonominë e universitetit. Prania e një rektori të një universiteti publik, i cili duhet të jetë i pavarur, në një mbledhje të një grupimi politik parlamentar, tregon qartë se arsimi i lartë po përdoret për interesa dhe axhenda të caktuara politike, duke e vënë institucionin akademik në shërbim të interesave të një partie apo grupimi politik.

6. Nisma "Kuvendojmë për Shqipërinë", përdorim i fondeve publike për aktivitete politike. Në takimet e kryera në kuadër të këtij programi vërehet mungesa e zëvendëskryetarit të Kuvendit të Shqipërisë z. Gjekmarkaj, i cili përfaqëson krahun tjetër politik, Partinë Demokratike të Shqipërisë. Pikërisht ky fakt, si dhe video e transmetimit të takimit "Kuvend-On", hedhin më tej dyshimet lidhur me natyrën tërësisht politike të këtyre aktiviteteve.

6. REKOMANDIME

1. Kuvendi i Shqipërisë duhet të përmirësojë kuadrin ligjor për të adresuar mangësitë që lejojnë partinë politike në pushtet të përdorë burimet publike, të cilat aktualisht janë formalisht të mbrojtura sipas legjislacionit të tanishëm, siç janë neni 91 i Kodit Zgjedhor, Ligji "Për Partitë Politike", dhe Ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore", në mënyrë strategjike për të përfituar një avantazh elektoral.
2. KQZ-ja duhet të vendosë sanksione proporcionale që i përgjigjen shkeljeve të rënda për përdorimin e institucioneve dhe burimeve shtetërore për qëllime elektorale.
3. KQZ-ja duhet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim parandalimin e propagandës elektorale në rrjetet sociale të institucioneve publike, në kuadër të zbatimit të vendimit të saj për ndalimin e tyre.
4. Media duhet të ketë një kontribut të rëndësishëm, të pavarur dhe të paanshme, për të raportuar publikisht raste të shkeljeve që kërkojnë nisjen e një hetimi, konform Kodit të Procedurës Penale.
5. Drejtuesit e Institucioneve Arsimore duhet të ndërgjegjësohen dhe të mos pranojnë kërkesat për përdorimin e ambjenteve publike të institucioneve të cilat ata drejojnë, kundërshtojnë kandidat, apo partisë politike, duke respektuar Nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe duke shmangur dëmin moral dhe administrativ që rrjedh prej tij.



7. ANEKSE

Aneks nr. 1 : Kallezimi per 36 Institucionet Arsimore



Tiranë, më 13.01.2025

KALLËZIM

KALLËZUES:

Qendra “Qëndresa Qytetare”, një organizatë jofitimprurëse e regjistruar me Vendimin Nr. 1120, datë 15.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Rruga “Ali Pashë Gucia”, Pallati nr. 42 me adresë elektronike qendresaqytetare@gmail.com, me Drejtor Ekzekutiv Z. Rigels Xhemollari, përfaqësuar me autorizim nga Z. Dhimitër Zguro.

KUNDËR:

1. Shkollës 9 – vjeçare “Mustafa Greblleshi”, Tiranë;
2. Shkollës 9 – vjeçare “Koli Sako”, Divjakë;
3. Shkollës 9 – vjeçare “Jashar Dunga”, Kajan;
4. Shkollës 9 – vjeçare “Liria”, Ajasem;
5. Shkollës 9 – vjeçare “Neim Muçelli”, Pretushë;
6. Shkollës 9 – vjeçare “Ahmet Zogu”, Kamëz;
7. Shkollës 9 – vjeçare “Shahin Kullolli”, Golik;
8. Shkollës 9 – vjeçare “Fatos Lami”, Zall-Mner;
9. Shkollës 9 – vjeçare “Klodian Tanushi”, Tiranë;
10. Shkollës 9 – vjeçare “Alush Grepcka”, Roskovec;
11. Shkollës 9 – vjeçare “Qamil Metalia”, Metaliaj;
12. Shkollës 9 – vjeçare “Kostandin Kristoforidhi”, Tiranë;
13. Shkollës 9 – vjeçare “Spille”, Spille;
14. Shkollës 9 – vjeçare “Ismail Jangulli”, Godvi;
15. Shkollës 9 – vjeçare “Koli Dimo”, Frashër;
16. Shkollës së Mesme të Bashkuar “Arif Zeqiri”, Golaj;
17. Shkollës së Mesme të Bashkuar Mark Jaku”, Gojan i Madh;
18. Shkollës së Mesme Pedagogjike “Pandeli Sotiri”, Gjirokastrë;
19. Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Tiranë;
20. Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Divjakë;
21. Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Elbasan;
22. Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Shkodër;
23. Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Pogradec;
24. Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Kamëz;
25. Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Roskovec;
26. Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Has;
27. Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Kavajë;
28. Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Pukë – Fushë Arrëz;



29. Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastrë – Libohovë;
30. Zyrës Arsimore Vendore të Arsimit Parauniversitar Bulqizë;
31. Zyrës Arsimore Vendore të Arsimit Parauniversitar Patos;
32. Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë;
33. Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës;
34. Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier;
35. Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë;
36. Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, me adresë: Rruga “Aleksandër Moisiu”.
37. Partisë Socialiste të Shqipërisë, me adresë: Sheshi “Austria”, Nr. 91, Tiranë.
38. Dhe çdo personi tjetër, të pa identifikuar deri më tani nga ana jonë, por që me veprime konkrete rezulton se ka përgjegjësi administrative.

OBJEKTI:

1. Konstatimin e përdorimit të burimeve publike.
2. Marrjen e sanksioneve administrative bazuar në dispozitat ligjore ndaj të gjithë personave të kallëzuar, si dhe atyre që do të identifikohen gjatë hetimit administrativ.
3. Ndalimin e angazhimit online, pavarësisht formës së shprehur nëpërmjet komentimit, pëlqimit apo shpërndarjes, të institucioneve publike me publikimet e titullarit të institucionit publik, si dhe fshirjen e menjëhershme të të gjitha postimeve me karakter elektoral nga faqet e institucioneve publike.

DREJTUAR:

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me adresë: Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr. 4, Tiranë, përfaqësuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**.

BAZA LIGJORE:

Nenet 91, 171 dhe 172, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”;
Neni 3 i Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

I nderuar Z. Komisioner,



Pasi jemi njohur me veprimet e mëposhtme, paraqesim para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, këtë kallëzim kundër të gjithë subjekteve të sipërcituara për shpërdorimin e burimeve publike, si dhe të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në cilësinë e partisë politike, që përfiton nga kjo veprimtari e ndaluar, si dhe çdo personi tjetër, që gjatë hetimit administrativ do të rezultojë se ka përgjegjësi, për arsyet si më poshtë vijon:


I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Nga data 11 janar dhe në vijim, monitoruesit e Qendrës “Qëndresa Qytetare” kanë vërejtur se, faqet zyrtare të institucioneve të arsimit parauniversitare, Zyrrave Vendore të Arsimit, si dhe faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, të gjitha këto institucione në varësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, janë angazhuar në forma të ndryshe, duke përfshirë pëlqimin, komentimin apo shpërndarjen, me postime që kanë në përmbajtje të tyre thirrje elektorale. Ne vijim, për të treguar shkallën e përhapjes së këtij fenomeni, do të përmendim disa nga rastet për secilin prej postimeve:

2. Më datë 11 janar 2025, ora 15:22, nga profili i Znj. Ogerta Manastirliu, është shpërndarë postimi me përmbajtjen si vijon: “*Athinë 🇬🇷- Kënaqësi e veçantë të takoja Linditën, Etlevën, Dudinën, Robertin, Durimin, Gastonin, tiranas të mirë e të mençur, që prej vitesh jetojnë në Athinë, por që kurrë s'i kanë shkëputur lidhjet me atdheun🇰🇲. Faleminderit Janit për organizimin dhe mbështetjen🙏. Bashkë ndamë informacionin mbi mundësinë historike të votës nga diaspora në zgjedhjet parlamentare të 11 Majit 2025 dhe procesin e regjistrimit në platformën e KQZ. Nga sot, 11 Janar nis regjistrimi për zgjedhësit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit🇰🇲 deri në 4 Mars! Regjistrohuni në Platformën Elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: <https://diaspora.kqz.gov.al> 🇰🇲 Mos e humb mundësinë të vendosësh për të ardhmen e fëmijëve dhe për Shqipërinë e 2030 🇰🇲 #DiasporaVoton🇰🇲 #PS2030🇰🇲 për #Shqipërinë2030🇰🇲*”¹

2.1 Në këtë postim janë angazhuar në formën e pëlqimit, ndër të tjera, Shkolla 9 – vjeçare “Mustafa Greblleshi”, Tiranë, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, Shkolla e Mesme e Bashkuar “Arif Zeqiri”, Golaj, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë [Prova nr. 1 – Printscreen i seksionit të pëlqimeve në postimin përkatës], dhe në formën e shpërndarjes, ndër të tjera, nga faqja zyrtare Shkollës Publike 9 – vjeçare “Koli Sako”, Divjakë, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier; Shkolla 9 – vjeçare “Jashar Dunga”, Kajan, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë [Prova nr. 2 – Shpërndarjet e postimit përkatës].

¹ Për më shumë shih: <https://fb.watch/x4OAP2PqQO/>, aksesuar online më 13.01.2025.



3. Më datë 11 janar 2025, ora 21:32, nga profili i Znj. Ogerta Manastirliu, është shpërndarë postimi me përmbajtjen si vijon: “*Athinë* - Bashkë me Belinda Balluku takuam Sarën, studenten ekselente të shkencave politike në Athinë, që ka dëshirën e pamatë për të kontribuar për *Shqipërisë2030*, duke nisur nga vota për herë të parë e për të bashkëpunuar edhe më tej për vizionin e *#Shqipërisë2030* *#KrenarëpërShqipërinë* *#VetëmPërpara* *#SHOIPËRIA2030*.”²

3.1 Në këtë postim janë angazhuar në formën e pëlqimit, ndër të tjera, Shkolla 9 – vjeçare “Liria”, Ajasem, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë, dhe Zyrën Vendore Arsimore Poliçan [Prova nr. 3 – Printscreen i seksionit të pëlqimeve në postimin përkatës], në formën e komentit nga Shkolla e Mesme e Bashkuar “Mark Jaku”, Gojan i Madh, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë [Prova nr. 4 – Printscreen i seksionit të komenteve në postimin përkatës], si dhe në formën e shpërndarjes, ndër të tjera, nga faqja zyrtare Shkollës Publike 9 – vjeçare “Neim Muçelli”, Pretushë, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë; Shkolla 9 – vjeçare “Ahmet Zogu”, Kamëz, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës [Prova nr. 5 – Shpërndarjet e postimit përkatës].

4. Më datë 12 janar 2025, ora 09:57, nga profili i Znj. Ogerta Manastirliu, është shpërndarë postimi me përmbajtjen si vijon: “*Takime me komunitetin shqiptar në Athinë për rëndësinë e votës historike të diasporës, si kontribut për të vijuar rrugën pa kthim të Shqipërisë2030 drejt familjes së madhe evropiane* *Nëse jeton jashtë Shqipërisë, regjistrohuni në Platformën Elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: <https://diaspora.kqz.gov.al>* *#DiasporaVotoni* *#PS2030* *për #Shqipërinë2030*.”³

4.1 Në këtë postim janë angazhuar në formën e pëlqimit, ndër të tjera, Shkolla 9 – vjeçare “Shahin Kullolli”, Golik, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë, dhe Shkolla 9 – vjeçare “Fatos Lami”, Zall-Mner, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës [Prova nr. 6 – Printscreen i seksionit të pëlqimeve në postimin përkatës], në formën e komentit nga Shkolla 9 – vjeçare “Klodian Tanushi”, Tiranë, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës [Prova nr. 7 – Printscreen i seksionit të komenteve në postimin përkatës], si dhe në formën e shpërndarjes, ndër të tjera, nga faqja zyrtare Shkollës Publike 9 – vjeçare “Neim Muçelli”, Pretushë, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë; Shkolla 9 – vjeçare “Alush Grepcka”, Roskovec, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier [Prova nr. 8 – Shpërndarjet e postimit përkatës].

² Për më shumë shih: <https://fb.watch/x4PDQK1xGe/>, aksesuar online më 13.01.2025.

³ Për më shumë shih:

<https://www.facebook.com/OgertaManastirliu/posts/pfbid05ELrnj1tkuP2B6TYn6RAvPndt9JHsfetvi89LX75UogW175NzsJNRyXuiK667bpFL/>, aksesuar online më 13.01.2025.



5. Më datë 12 janar 2025, ora 12:46, nga profili i Znj. Ogerta Manastirliu, është shpërndarë postimi me përmbajtjen si vijon: “Takime entuziaste në Athinë me komunitetin shqiptar, që po tregojnë një interes të madh për ushtrimin e të drejtës së votës së diasporës në zgjedhjet e **#11Majit**, me dëshirën dhe krenarinë për ta çuar Shqipërinë në majën që i takon, në familjen e madhe evropiane 🇪🇺 🇫🇷 ***Regjistrohu në Platformën Elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: <https://diaspora.kqz.gov.al>** 🇮🇹 **#DiasporaVoton** 🇸🇰 **#KrenarëpërShqipërinë** 🇨🇪 🇵🇸 **#VetëmPërpara** 🇸🇰 **#SHOIPËRIA2030** 🇮🇹”.⁴


5.1 Në këtë postim janë angazhuar në formën e pëlqimit, ndër të tjera, Zyra Vendore Arsimore Dimal, dhe Shkolla 9 – vjeçare “Qamil Metalia”, Metaliaj, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë [Prova nr. 9 – Printscreen i seksionit të pëlqimeve në postimin përkatës], në formën e komentit nga Shkolla 9 – vjeçare “Klodian Tanushi”, Tiranë, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës [Prova nr. 10 – Printscreen i seksionit të komenteve në postimin përkatës], si dhe në formën e shpërndarjes, ndër të tjera, nga faqja zyrtare Shkollës Publike 9 – vjeçare “Neim Muçelli”, Pretushë, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë [Prova nr. 11 – Shpërndarjet e postimit përkatës].

6. Më datë 13 janar 2025, ora 08:53, nga profili i Znj. Ogerta Manastirliu, është shpërndarë postimi me përmbajtjen si vijon: “Këtë fundjavë nisi për herë të parë në historinë e zgjedhjeve pluraliste regjistrimi i votuesve të 11 majit në diasporë 🇪🇺 Kush është jashtë dhe dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje, duke votuar me postë nga aty ku banon, duhet të regjistrohet që të marrë fletën - votimit në adresën e tij/saj dhe pastaj ta rikthejë me atë postë ***Ne e mbajmë flulën dhe e miratuar ligjin për votimin nga jashtë vendit, tani është radha juaj të na jepni mbështetjen që të vazhdojmë përpara Bashkë për Shqipërinë 2030** 🇪🇺 🇫🇷 🇸🇰”.⁵

6.1 Në këtë postim janë angazhuar në formën e pëlqimit, ndër të tjera, Zyra Vendore Arsimore Dimal, dhe Shkolla 9 – vjeçare “Kostandin Kristoforidhi”, Tiranë, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës [Prova nr. 12 – Printscreen i seksionit të pëlqimeve në postimin përkatës], në formën e komentit nga Zyra Vendore e Arsimit Bulqizë [Prova nr. 13 – Printscreen i seksionit të komenteve në postimin përkatës], si dhe në formën e shpërndarjes, ndër të tjera, nga faqja zyrtare Shkollës Publike 9 – vjeçare “Spille”, Spille, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe Shkolla e Mesme Pedagogjike “Pandeli Sotiri”, Gjirokastër, nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier [Prova nr. 14 – Shpërndarjet e postimit përkatës].

⁴ Për më shumë shih: <https://fb.watch/x4S8BJ0-he/>, aksesuar online më 13.01.2025.

⁵ Për më shumë shih: <https://www.facebook.com/reel/964515175577279>, aksesuar online më 13.01.2025.



7. Këto angazhime sistematike në këto postime, dhe në postime të tjera që përmbajnë logon e Partisë Socialiste [Prova nr. 15 – Postimet e tjera], dëshmojnë qartë për një vënie në përdorim të burimeve publike të një partie politike, në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor.

II. E DREJTA E APLIKUESHME

8. Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”:

- (i) **Neni 91 “Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore”** parashikon: “1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.”
- (ii) **Neni 171 “Sanksionet administrative”** parashikon: “1. Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve osenga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3,000 deri në 90,000 lekë. 2. Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë.”
- (iii) **Neni 172 “Sanksionet për subjektin zgjedhor për shkelje të ndalimeve të këtij ligji”** parashikon: “1. Subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijeni, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Kundërvajtja administrative sipas kësaj pike dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë.”

9. Vendimi i Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”:

- (i) **Neni 3 “Veprimtari të ndaluara”** parashikon: “1. Në zbatim të këtij vendimi: 1.3 “veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: c) vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme



të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njërive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit".

III. ANALIZA LIGJORE

A. Në lidhje me kërkimin e parë dhe të dytë:

10. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të Kodit Zgjedhor me ato të vendimit nr. 9, të Komisionit Rregullator, që të ndodhemi përballë një shkeljeje administrative që lidhet me (keq)përdorimin e burimeve shtetërore, duhet që të plotësohen disa kushte në mënyrë kumulative. Së pari, duhet që veprimtaria të jetë kryer nga një prej subjekteve të ngarkuar me detyrime nga ligji dhe aktet nënligjore. Së dyti, duhet që veprimtaria të përfshijë vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të Kodit Civil, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike. Dhe së treti, duhet që vënia në dispozicion e aseteve publike të jetë bërë për qëllime zgjedhore.

11. Përsa i takon kushtit të lidhur me subjektet, ligjvënësi në pikën 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor bën një përcaktim të përgjithshëm duke sanksionuar se me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, burimet publike nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje. Në rastin konkret, burimet publike të vendosura në dispozicion të Partisë Socialiste janë faqet zyrtare të institucioneve të arsimit parauniversitar, si dhe të organeve që duhet të mbikëqyrin ligjshmërinë e veprimtarisë së këtyre institucioneve, në referim të ligjit. Për rrjedhojë, ky kusht i parë në lidhje me subjektin ndaj të cilit duhet të jenë vënë në mbështetje dhe prej të cilit janë përdorur burimet, plotësohet në rastin konkret.

12. Përsa i takon kushtit të dytë të lidhur me vënien në dispozicion të burimeve publike, duhet që burimet të jenë asete të luajtshme ose të paluajtshme në pronësi të organeve publike qendrore ose të njërive të vetëqeverisjes vendore. Siç rezulton edhe nga rrethanat e çështjes, në rastin konkret, faqet zyrtare të institucioneve janë përdorur për llogari të forcës politike, Partia Socialiste me qëllim që kjo e fundit të mund të përfitojë një avantazh të padrejtë. Përsa më sipër, në rastin konkret, provohet tërësisht përmbushja e këtij kushti të dytë.

13. Përsa i takon kushtit të tretë që lidhet me qëllimin e vënies në dispozicion të aseteve publike, referuar pikës 2, të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, për efekt të ngarkimit me përgjegjësi administrative duhet që vënia në dispozicion e aseteve shtetërore e publike të jetë



bërë për qëllime zgjedhore. Në rastin konkret, është e qartë që vënia në dispozicion e aseteve shtetërore është bërë për qëllime zgjedhore. Po ashtu, për aq kohë sa nga përdorimi i burimeve publike është kryer në favor të një partie politike, edhe kjo e fundit duhet të mbahet përgjegjëse për shkelje të ndalimeve të Kodit Zgjedhor.

B. Në lidhje me kërkimin e tretë:

14. Shpërndarja masive e postimeve të titullarit të institucionit nga ana e institucioneve në varësi u vërejt edhe në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në të tilla kushte, përmes Vendimit nr. 421, datë 3.5.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vendosi që, për shkak të kufizimit që neni 3 pika 1.3, shkronja “ç”, parashikon “përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore” dhe paqartësive në lidhje me postimet, urdhërohet ndalimi i ripostimit në faqet zyrtare të një institucioni publik, të aktiviteteve të cilat pasqyrohen në profilet personale të drejtuesit të një institucioni publik, për sa kohë këto profile i konsiderojnë profile të tyre personale. Në rastin konkret, duke vlerësuar se gjendemi përballë të njëjtave kushte, krahas masave administrative që synojnë ndëshkimin me gjobë të subjekteve që kryejnë kundërvajtje administrative, kërkohet marrjen e masës së ndalimit të angazhimit online, pavarësisht formës së shprehur nëpërmjet komentimit, pëlqimit apo shpërndarjes, të institucioneve publike me publikimet e titullarit të institucionit publik, si dhe fshirjen e menjëhershme të të gjitha postimeve me karakter elektoral nga faqet e institucioneve publike.


IV. KONKLUZIONE:

15. Përsa më lart, mbështetur në nenin pikën 1 dhe 2, të nenit 91, në pikën 1, të nenit 171 dhe në pikën 1, të nenit 172, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë; pikën 1 dhe 2, të nenit 3 dhe pikën 1, të nenit 10, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9/2020, përfundimisht,

KËRKOJMË:

1. Konstatimin e përdorimit të burimeve publike.
2. Marrjen e sanksioneve administrative bazuar në dispozitat ligjore ndaj të gjithë personave të kallëzuar, si dhe atyre që do të identifikohen gjatë hetimit administrativ.
3. Ndalimin e angazhimit online, pavarësisht formës së shprehur nëpërmjet komentimit, pëlqimit apo shpërndarjes, të institucioneve publike me publikimet e titullarit të institucionit publik, si dhe fshirjen e menjëhershme të të gjitha postimeve me karakter elektoral nga faqet e institucioneve publike.

Për “QËNDRESA QYTETARE”

()
Dhimitër ZGURO



#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDORSEMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al